



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë. 27. 11.2012
Nr. 0204-1298

PËR: Haki Rugova, Kryetar i Komunës së Istogut
Demë Çeta, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Istogut,

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS
SË ISTOGUT NR, 43/2012, të pranuar më datën 20.11.2012,

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Ligjin Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit. Nr, 43/2012 të miratuar me datë 31.10.2012 nga Kuvendi i Komunës së Istogut, KONFIRMON ligjshmërinë e aktit dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili prodhon efekt të plotë juridik:

- Vendimi Nr. 43/2012, për formimin e komisioni për ndërtimin e rrugëve dhe shesheve në tërë territorin e Komunës në përbërje prej 7 (shtatë) anëtarëve.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Drejtorëve të Departamenteve dhe Zyrave
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana. 27. 11.2012
Br. 0204-1298

Za: Haki Rugova, Gradonačelnik Opštine Istok
Demë Çeta, Predsedavajući Skupštine Opštine Istok,

PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKE SKUPŠTINE OPŠTINE ISTOK BR, 43/2012, primljeno dana 20.11.2012,

Poštovani,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim po Zakonu za lokalnu samoupravu br. 03/L-040, Zakonu br. 03/L-049 o Finansijama lokalne samouprave, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja Odluke br, 43/2012 usvojene dana 31.10.2012 od Skupštine Opštine Istok, POTVRDJUJE zakonitost akta i procenjuje da je isti u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu.



Pravni Akt koji proizvodi puni pravnin efekat :

- Odluka br. 43/2012, za formiranje komisije za izgradnju puteve i trgova na celoj teritoriji opštine u satave od 7 (sedam) članova.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik Premijera i Ministar MALS,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Direktorima uprava i kancelarija
Arhivu MALS-a

| | | | |
|--|--------------------------|---------------------|---|
|  Republika e Kosovës | KUVENDI I KOMUNËS | |  Komuna e Istogut |
| | 01 Nr.43/2012 | Data: 31.10.2012 | |

Kuvendi i Komunës në bazë të nenit 40. paragrafi 40.2. pika e) të Ligjit për vetëqeverisjen e lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008) dhe nenit 33.1. pika 5. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10, në mbledhjen e mbajtur më: 31.10.2012 mori këtë:

V E N D I M

- I. Formohet Komisioni për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në tërë territorin e komunës në përbërje prej 7 / shtatë/ anëtarëve sipas strukturës në vijim:

| | | | |
|---|--------------|--------|-------|
| REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLICA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO VEHTMJE E KOSOVES VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA | | | |
| Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije Ministry of Local Government Administration | | | |
| Data Datum 20. 11. 2012 Date | | | |
| Nivësi organizativ | Nr. i Lëndës | Shojca | Vlera |
| - III - | 0024-8948 | | |

 1. Një anëtarë nga radhët e LDK-së, kryetar;
 2. Një anëtarë nga radhët e AAK-së, anëtar;
 3. Një anëtarë nga radhët e PDK-së, anëtar
 4. Një anëtarë nga radhët e LDD-së, anëtare;
 5. Një anëtarë nga radhët e minoriteteve, anëtar;
 6. Një anëtarë nga radhët e ekzekutivit komunal, anëtar dhe
 7. Një anëtarë nga radhët e shoqatave të dala nga lufta, anëtar.

- II. Komisioni i cekur më lartë, do të bëjë propozimin e emërtimit të të gjitha rrugëve dhe shesheve në tërë territorin e komunës dhe këto propozime do t'ia dërgojë kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim; gjatë punës së tij do të bashkëpunojë ngushtë qytetarët e lagjes dhe rrugëve për të cilat propozohet emërtimi dhe me shoqatat e ndryshme të shoqërisë civile ashtu siç është përcaktuar me Ligjin mbi adresat dhe udhëzimet administrative përkatëse; të gjitha vendimet komisioni për çështje të emërtimit të rrugëve dhe shesheve do t'i marrin me konsensus; si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe përgjegjësit të tjera që janë në natyrën e këtij komisioni.

- III. Obligohen të gjitha subjektet që sa më parë të njoftojnë me emrat e anëtarëve të komisionit të cekur në këtë vendim.

- IV. Punët administrativo-teknike për nevoja të këtij komisioni do të kryhen nga shërbimi për punë të kuvendit.

- V. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdesën: anëtarët e komisionit dhe shërbimi për punë të kuvendit.

- VI. Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: anëtarët e komisionit, shërbimi për punë të kuvendit dhe një kopje në arkivin e Kuvendit.



K r y e s u e s i
Demë Çeta